

**STATUTI DHE AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZAR
“ZHAKLIN”**

Sot, më datë 04/12/2023,

Znj. **Vjola VEIZAJ**, e bija e Xhelal dhe Vjollca, e datëlindjes 17.10.1981, mbajtëse e letërnjoftimit me Nr 033588048 dhe nr personal I16017031U, madhore e me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

Në përputhje me Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” (i ndryshuar) dhe Ligjit Nr 9723, dt 03.05.2007 “Për regjistrimin e Biznesit” (i ndryshuar), ka vendosur të themelojë një Shoqëri me përgjegjësi të Kufizuar të emërtuar “ZHAKLIN” shpk, (më poshtë referuar Shoqëria),

Statuti dhe Akti i Themelimit siç përcaktohen këtu janë në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe kanë karakter të detyrueshem, ndërsa çështjet qe nuk janë shprehimisht të parashikuara në to plotësohen nga legjislacioni sliqiptar.

**Neni 1
EMËRTIMI DHE LOGO**

1.1 Emri i Shoqërisë është “ZHAKLIN” shpk (në vijim referuar si shoqëria). Ky emërtim është i vetmi i shoqërisë dhe do të përdoret ne te gjitha regjistrimet, transaksionet, marrëveshjet dhe komunikimet e saj me te tretët dhe është i vlefshëm si brenda dhe jashtë vendit.

1.2 Shoqëria do të kete vulën dhe logon e saj identifikuese, në formën e percaktuar nga Ortaku i vetem i shoqërisë.

**Neni 2
SELIA**

2.1 Selia zyrtare e Shoqërisë ndodhet në adresën: Rr. Koço Kazanxhi, Ish Dega Ushtarake, Lagjia 12, Pallati 624, kati 1,Durrës.

2.2 Shoqëria mund të çelë dhe /ose zyra përfaqësimi brenda dhe jashtë Republikës së Shqipërisë, si dhe të transferojë selinë e shoqërisë në një adresë apo qytet tjetër.

**Neni 3
KOHËZGJATJA**

Kohëzgjatja e Shoqërisë do të jetë për një afat të pacaktuar, përveç zgjatjes ose prishjes së mëparshme të saj sipas Vendimit të Asamblesë së Ortakëve.

**Neni 4
OBJEKTI I VEPRIMTARISË**

4.1 Shoqëria mund të kryejë çdo aktivitet të lejuar me ligj në Republikën e Shqipërisë, duke përfshirë por pa u kufizuar në:

- Importimin dhe eksportim si dhe tregtim me shumicë dhe pakicë e pjesë këmbimi të pajisjeve profesionale dhe elektro shtëpiake, si lavatriçe, frigorifere, televizore, aspirator, kondicionerë, etj.



- Tregtim me shumicë dhe pakicë si dhe importin dhe eksportin e artikujve të ndryshëm industriale dhe ushqimore.
- Prodhimi dhe tregtimi i artikujve bujqësorë, blegtorale, frutikulturë, olivi kulture, perime drithëra etj, si dhe përpunimi i tyre industriale, import-eksportin e tyre.
- Tregtim i artikujve të ndryshëm të të gjitha llojeve me shumicë dhe pakicë, artikuj të ndryshëm ushqimorë, elektrike, hidrosanitar, hidraulike, prodhime qeramike, konfeksione të ndryshme, prodhime kozmetike dhe estetike, bime medicinale dhe eterovajore.
- Tregtim të lëndës drusore, bojrave të ndryshme plastike për mure e fasada, kimikate e lëndë të para për prodhimin e tyre.
- Hapje dhe shfrytëzim hotelesh, bare, restorante, diskoteka, qendra pushimi dhe kurative. marshtim dhe tregtim të peshkut me shumicë dhe pakicë.
- Punime druri mobilje e orendi prodhime duroalumini dhe tregtimi i tyre.
- Prodhim materiale të ndryshme ndërtimi si pllaka për shtrim e veshje të objekteve të ndërtimit, banesave, tulla e tjegulla të llojeve të ndryshme.
- Investime dhe pjesëmarrje në investime duke bashkëpunuar me shoqëri të tjera vendase dhe të huaja në fushat e industrisë, bujqësisë, industrisë ushqimore transport si dhe ndërtim të objekteve si të banesave shumë katëshe të godinave të llojeve të ndryshme etj.
- Aktivitet në fushën e transportit të brendshëm e të jashtëm për udhëtarë e për mallra në mënyrë tokësore si dhe servise për të gjitha llojet e automjeteve.
- Dhënie me qira e ambjenteve / pasurive të paluajtshme;
- Shërbime transport mallrash; auto-servis, shërbime telemarketingu ose marketingu online etj, në të gjitha fushat e mësipërme por duke mos u limituar në to;

4.2 Shoqëria mund të kryejë gjithashtu të gjitha operacionet tregtare, mbi pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme, Operacione financiare, industriale që do të vlerësohen të nevojshme apo të dobishme për realizimin e objektin e shoqërisë si dhe blerje pjesëmarrje në kapitale themeltar të shoqërive të tjera, që kanë objekt të njëjtë/ të ngjashëm apo që lidhet me të vetin. Shoqëria në ushtrimin e aktivitetit të saj do të marrë të gjitha autorizimet dhe lejet e nevojshme pranë Institucioneve publike shqiptare, dhe do të mbështetet në rregullat dhe normat në fuqi në lidhje me ushtrimin e veprimtarisë së saj të rregullt ekonomike.

NENI 5 KAPITALI THEMELTAR

5.1 Kapitali themeltar, është i përbërë nga kontributi në të holla i ortakut themelues në vlerën 10.000.000 (dhjetë milion) lek dhe është i përbërë nga një kuotë.

5.2 Pjesëarrja e themeluesit në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet si mëposhtë: Ortaku themelues Vjola Veizaj: Zotëruese e i (një) kuote me vlerë të përgjithshme që përbën 100 % të kapitalit themeltar të shoqërisë të barabartë me 10.000.000 (dhjetë milion) lek. Kapitali për momentin është i pa ndarë. Kapitali mund të shtohet ose të pakësohet në përputhje me ligjet Shqiptare.

NENI 6 PJESËMARRJET NË KAPITALIN THEMELTAR

6.1 Pjesëmarrjet e ortakut në kapitalin themeltar përcaktohen në raport të drejtë me kontributet e tij në kapitalin themeltar.



6.2 Të drejtat, përfshirë edhe e drejta e votës, i takojnë ortakëve në mënyrë përpjestimore me pjesëmarrjen që zotëron secili në kapitalin themeltar. Në rast tjetërsimi të pjesëmarrjes në kapitalin themeltar, ortakët e tjerë gëzojnë të drejtën e parablerjes. Me “tjetërsim” do të kuptohet çdo akt tjetërsimi i kuotave, në kuptimin më të gjerë të fjalës, si në pronësi të plotë ashtu edhe të pjesëshme, që, në mënyrë direkte apo indirekte, sjell ndryshimin e titullit të pronësisë mbi kuotat ose të drejtat mbi to. Ortaku që synon të tjetërsojë, tërësisht ose pjesërisht, kuotat e tij në kapitalin themeltar duhet ti komunikojë ortakëve të tjerë nëpërmjet një letre rekomande ofertën e marrë duke treguar emrin e blerësit të mundshëm dhe kushtet e tjetërsimit, në mënyrë të veçantë çmimin e përcaktuar nga mënyra e pagesës (këtu e më poshtë oferta).

6.3 Brenda 20 ditëve nga marrja e komunikimit të ofertës, ortakët e interesuar në ushtrimin e së drejtës së parablerjes duhet ti komunikojnë ortakut që kalon të drejtat mbi kuotat, dëshirën për të ushtruar të drejtën e parablerjes, përpjestimisht me pjesëmarrjen e secilit në kapitalin themeltar sipas kushteve të ofertës duke shprehur edhe interesin e mundshëm për blerjen e pjesës së kuotave për të cilën nuk është ushtruar e drejta e parablerjes nga ana e ortakut/ëve të tjerë. Është i pavlefshëm çdo komunikim që nuk përmban të gjitha të dhënat e mësipërme.

6.4 Në rast se ndonjë nga personat që gëzon të drejtën e parablerjes së kuotave nuk dëshiron ta ushtrojë atë, e drejta e parablerjes që i takon zmadhohet automatikisht edhe përpjestimisht në favor të ortakëve që kane shprehur interesin për të ushtruar këtë të drejtë. Në rast se janë disa ortakë që ushtrojnë të drejtën e parablerjes, kuotat do të shpërndahen nëpërmjet tyre në përpjestim me pjesëmarrjen e tyre në kapitalin e shoqërisë. Në rast se në letrën e komunikimit të ofertës tregohet si blerës i mundshëm një person që është ortak, edhe atij i njihet e drejta e parablerjes krahas ortakëve të tjerë.

6.5 Në rastin e ushtrimit të së drejtës së parablerjes, nënshkrimi i kontratës së shitjes së kuotave dhe pagesat përkatëse duhet të kryhet brenda afateve të përcaktuara në propozimin e shitjes nga ortaku ofrues.

6.6 Nëse e drejta e parablerjes nuk ushtrohet brenda afateve të mësipërme dhe për tërësinë e pjesëmarrjes së ofruar, ortaku ofrues mund ti transferojë kuotat e veta në favor të blerësit të treguar në komunikimin e ofertës dhe në kushtet e parashikuara në të brenda 60 ditëve të ardhshme, në të kundërt procedura e parablerjes duhet të përsëritet. Në rast tjetërsimi të kuotave në favor të të tretëve pa zbatuar dispozitat e parashikuara më sipër blerësi nuk do të legjitimohet në ushtrimin e të drejtave administrative dhe pasurore dhe tjetërsimi i kuotave nga ana e tij nuk do të prodhojë efekte ndaj shoqërisë.

6.7 Nëse njëri prej ortakëve nuk e ushtron të drejtën e parablerjes në mënyrat e përcaktuara, ortaku ofrues mund të nënshkruaj aktin e shitjes së pjesës së tij në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

NENI 7

ZMADHIMI DHE ZVOGËLIMI I KAPITALIT

7.1 Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nëpërmjet emërimit të një eksperti të autorizuar për këto kontribute sipas kërkesës së administratorit.

7.2 Në asnjë rast nuk mund të detyrohet një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

7.3 Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.

7.4 Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

NENI 8 TRANSFERIMI I KAPITALIT

8.1 Kuotat e kapitalit të shoqërisë dhe të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë,
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- d) dhurimit;
- dh) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

8.2 Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, për sa nuk parashikohet ndryshe në statut,

8.3 Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie,

NENI 9 ORGANET E SHOQËRISË

9.1 Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë, e cila vepron në përputhje me Statutin e Shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi. Ajo miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.

9.2 Asambleja e përgjithshme e ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- dh) mbikqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgaritjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- t) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe me procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti, Ortaku mund të përfaqësohet në asamblesë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

9.3 Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme. Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

NENI 10

MËNYRA E THIRRJES SË MBLEDHJES SË ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME

Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, nëse parashikohet nga statuti, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me rresazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë. Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

NENI 11

KUORUMI

11.1 Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejte vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave.

11.2 Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të së njëjtit ligj.

11.3 Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të permendur më lart, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

NENI 12

MARRJA E VENDIMEVE

12.1 Asambleja e përgjithshme vendos me tri tq katqrtat e votave të zotëruesve të kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë,

12.2 Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje të tjera si:

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- ç) përcaktimin e shpërblimeve
- d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve, ecurisë së veprimtarisë
- e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

12.3 Cdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKB për të pasyqruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.

NENI 13 PËRJASHTIMI NGA E DREJTA E VOTËS

13.1 Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për:

- a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;
- b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
- c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
- d) dhënien ose jo të përfitimeve të reja.

13.2 Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jete në të njëjtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson,

NENI 14 ADMINISTRIMI

14.1 Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizike si administratorë të shoqërisë.

14.2 Afati i emërimit, është 5 vjet, me të drejtë ripërtëritje.

14.3 Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit

14.4 Caktohet si Administratore parë e shoqërisë, Znj Vjola VEIZAJ, e bija e Xhelal dhe Vjollca, e datëlindjes 17.10.1981, mbajtëse e letërnjoftimit me Nr 033588048 dhe nr personal I16017031U shtetase Shqiptare, madhore dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar e cila zgjidhet si administratore për një periudhë prej 5 vjet me të drejtë rizgjedhjeje.

NENI 15 KOMPETENCAT E ADMINISTRATORËVE

15.1 Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:

- a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
- c) kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- d) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhëna të detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Biznesit;
- e) raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- i) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

15.2 Administratorët janë të detyruar të thërasin Asamblenë e Përgjithëshme, në rastet kur:



-sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndermjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktiveti i shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.

-shoqëria propozon të shesë apo ti disponojë në mënyrë tjetër aktivet, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 (pesë) përqind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të çertifikuara.

-shoqëria, brenda 2 viteve tëpara pas regjistrimit të saj, propozon të blej nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 përqind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të çertifikuara,

15.3 Nëse asambleja e përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkarisht shoqërinë.

15.4 Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme.

15.5 Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

NENI 16

PËRGJEGJËSITË E ADMINISTRATORIT

16.1 Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë. Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

16.2 Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", administratori detyrohet:

a) ti kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;

b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;

c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;

y) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personale me ata të shoqërisë;

d) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

16.3 Administratori/ët, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

16.4 Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standartet profesionale, sipas pikave I e 2 të këtij neni, është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vertetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara.

Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.

16.5 Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", kryen veprimet e mëposhtme:

- a) u kthen ortakëve kontributet;
- b) u paguan ortakëve interesa apo dividend;
- c) u shpërndan aktivet shoqërisë;
- d) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej ti parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
- dh) jep kredi.

16.6 Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose së bashku, kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit.

16.7 Paditësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpërblimin financiar, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkesë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

NENI 17 PERSONELI I SHOQËRISË

Për punonjësit që do të punësohen, marrëdhëniet juridike dhe të punësuarve rregullohen nëpërmjet kontratës së punës në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi dhe në veçanërisht të Kodit të Punës.

NENI 18 VITI FINANCIAR- EKSPERTËT

18.1 Viti financiar i Shoqërisë fillon me 01 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Përgjatimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

18.2 Në mbyllje të çdo viti ushtrimor, Organi Administrativ, harton pasqyrat financiare të vitit ushtrimor, brenda afateve dhe në përputhje me dispozitat e ligjit. Bilanci mund t'u paraqitet ortakëve për tu miratuar brenda 180 ditëve nga mbyllja e vitit ushtrimor. Dokumentat e kontabilitetit të shoqëruara nëse është e nevojshme nga relacioni i ekspertëve kontabël të autorizuar duhet t'u komunikohet ortakëve dhe të vihet në dispozicion të tyre pranë selisë së shoqërisë të paktën 15 ditë përpara datës së mbledhjes së asamblesë.

NENI 19 EKSPERTËT DHE KONTROLLI I SHOQËRISË

19.1 Në shoqëri kontrolli ushtrohet nga një auditues ligjor (ekspert kontabël i autorizuar).

19.2 Emërtimi i audituesit ligjor bëhet nga asambleja e përgjithshme në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi për auditimin.



19.4 Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimtarisë ekonomiko tregtare të shoqërisë, atë vjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë i ngarkuar nga ana e ortakëve.

19.5 Në përfundim të kontrollit eksperti kontabël i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe për atë për kontrollet periodike të ushtruara.

NENI 20 FITIMET

20.1 Fitimet që rezultojnë nga viti ushtrimor do të shpërndahet nëpërmjet ortakëve pasi të jenë zbritur nga kjo shumë vlera e humbjeve të pësuar gjatë vitit ushtrimor. Aksionerët synojnë që shpërndarjet e fitimit të jenë vjetore përveç rasteve kur vendimi i aksionerëve është unanim për akumulimin e fitimeve.

20.2 Pjesa që mbetet pas zbritjes së zërave të mësipërm do tu shpërndahet pronarëve të kuotave të kapitalit themeltar përpjestimisht me pjesëmarrjen e tyre, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi me përjashtim të destinimit të ndryshuar të vendosur nga vetë ortakët.

NENI 21 FINANCIMI I ORTAKËVE

Shoqëria mund të marrë nga ortakët financime me ose pa shpërblim, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi. Dhënia e këtyre financimeve nga ana e ortakëve është e lirë. Çdo financim nga ana e ortakëve duhet të shoqërohet me kontratë të nënshkruar mes palëve dhe të jetë aprovuar nga asambleja e ortakëve.

NENI 22 PRISHJA DHE LIKUIDIMI

22.1 Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë:

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të Asamblesë së Ortakëve;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit
- y) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723. datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit";
- d) me vendim të gjykatës;

22.3 Në këtë rast Ortakët marrin vendim me shkrim në të cilin parashikojnë mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar një apo disa likuidatore dhe shënuar në cdo dokument të nxjerrë prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesën shtesë "Shoqëri në likuidim e sipër",

22.4 Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur nje procedurë falimentimi. Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortakët. Nëse Ortakët nuk marrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

NENI 23 RIORGANIZMI I SHOQËRISË BASHKIMI-NDARJA



Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX III Ligjit 9901 datë 14.04.2012 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare."

NENI 24

BAZA LIGJORE LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij në përputhje të plotë me këtë statutin dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar. Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

NENI 25

MOSMARRËVESHJET

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tretëve, do të jetë kompetente Gjykata Shqiptare, Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

NENI 26

DISPOZITAT E FUNDIT

Ky statut u hartua në 1 (një) kopje të njëjtë në gjuhën shqipe. Lexuar, pranuar dhe nënshkruar nga ortaku themelues i shoqërisë.

ORTAKU THEMELUES I SHOQËRISË

"ZHAKLIN" shpk

VJOLA VEIZAJ

